



USHQIMI ORGANIK

më afër
konsumatorëve

Проектот е финансиран
од Европската унија



5 për shëndetin:

Përmbajnë materje natyrore më suhqimore, siç janë shqerat natyrore, vitamin C, karotinoide, antioksidanse, dhe sasi të madhe të materjeve minerale siç janë kalciumi, megneziumi dhe hekuri.

Përmbajnë materje më pak të dëmshme. Studimet tregojnë se perimet gjethore organike përmbajnë 10 deri në 40% më pak nitrate, për shkak të mospërdorimit të plehrave artificiale në prodhimin.

E minimizon eksponimin tonë ndaj pesticideve. Në prodhimin konvencional bujqësorë përdoren më shumë se 400 pesticide të ndryshme, ashtu që mbeturinat e tyre shpesh janë prezente edhe në ushqimin dhe mund të shkaktojnë rrezik ndaj shëndetit.

Përmbajnë më pak aditive. Në prodhimin e ushqimit në Bashkimin Evropian, përdoren 290 aditive, ndërsa në prodhimin organik lejohet vetëm 32 aditive reptësisht të caktuara.

Nuk kanë hormone, organizma gjenetike të modifikuara (GMO), antibiotikë dhe medikamente të tjera sintetike. Medikamentet sintetike që përdoren në prodhimin joorganik të ushqimit mund të shkaktojnë kancer ose zhvillim të bakterjeve që janë rezistente ndaj antibiotikëve.

5 për mjedinin:

Nuk ndotet toka dhe uji nuk ndoten. Kjo kryhet në nëpërmjetë përjashtimit të përdorimit të plehrave artificiale dhe pesticide kimike për prodhimin e të cilëve shpenzohet sasi e madhe e energjisë dhe të cilët e ndotin gjithashtu tokën dhe ujin.

Mos e prishni tokën. Një nga parimet kryesore të prodhimit organik të ushqimit është rotimi i më shumë llojeve të kulturave bujqësore, me qëllim që të shpenzohen materjet ushqimore, si edhe të pengohet zhvillimi i sëmundjeve.

Kursehet energji. Kjo kryhet edhe me anë të përjashtimit të përdorimit të plehrave artificiale dhe pesticideve kimike për prodhimin e të cilëve shpenzohet sasi e madhe e energjisë.

Pengohet zgjerimi i sëmundjeve. Prodhimi organik përdorë armiq natyrorë ndaj dëmtuesve, parazitëve dhe sëmundjeve, përfshirë edhe lloje të dobishme të insekteve si dhe rotacion të kulturave të ndryshme bujqësore në tokë bujqësore.

Nxitet marrëdhënie e mirë ndaj kafshëve. Kafshët kollisin në kullota në lartësi të madhe malore, ndërsa fermave organike ju mundësohet lëvizje të lirë dhe sjellje natyrore.

Prodhimet organike prodhohen në toka të pandotura dhe të prodhuara me metoda të cilat nuk janë të dëmshme për shëndetin e njeriut, mjedisit dhe baraspeshën natyrore. Mënyra e prodhimit e ushqimit organik është rregulluar me ligj dhe rregullisht kontrollohet me qëllim që të sigurohet se prodhimet janë të sigurta dhe nuk përmbajnë materje të dëmshme. Me këtë ato janë më të shëndetshme dhe kanë vlerë më të lartë ushqimore

Çka është ajo që e parandalon që ushqimi organik të jetë më afër konsumatorët?

Pengesat në lidhje me mbështetjen e prodhimit organik:

- E ulët është oferta e lëndëve të para në tregun vendor – fara, fidane dhe pesticide – që lejohen të përdoren për prodhimin organik të bimëve.
- Toka bujqësore shtetërore ipet me qira sipas kritereve të cilat nuk e stimulojnë prodhimin organik.
- Kushtet administrative janë të komplikuar për përdorimin e ndihmës shtetërore.
- Nuk mjaftojnë aktivitetet arsimore dhe edukative për bujqit organik.

Pengesa për kontrollë të prodhimeve organike dhe mbrojtjen e konsumatorëve:

- Prodhuesit e Maqedonisë nuk janë konsistent në etiketimin e ushqimit organik.
- Nuk realizohet fushatë më e gjerë informative me të cilën opinionit do ti prezantohen pasojat mbi mjedisin nga përdorimi i pesticideve kimike në bujqësinë konvencionale.
- Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe menaxhimit të ujit nuk posedon regjistër në hap me kohën të publikuar të prodhuesve të qertifikuar.
- Nuk ekzistonë rrjetë të mekanizmave për kontroell të cilat do të kujdesen për mbrojtjen e konsumatorëve nga mashtrimet sikurse shënimi, informim ose reklamim joadekuat.



Vetëm 0,5% nga toka bujqësore përdoret për prodhim organik

Pengesa për promovim dhe plasman më të mirë i prodhimeve organike:

- Te konsumatorët nuk ekziston vetëdije të mjaftueshme për përfitimet nga ushqimi i prodhuar në mënyrë organike, si në drejtim të shëndetit, ashtu edhe në drejtim të mjedisit.
- Mungon strategji e përbashkët për marketing, qasje të përbashkët në supermarketet, në tregjet e gjelbra, kapacitetet turistike dhe të shërbimit dhe prezencë më të madhe të prodhuesve në internet, në rrjetet sociale dhe në mediat tjera të reja.
- Mungojnë qendra për blerjen e ushqimit organik, ndërsa kapacitetet për përpunim dhe paketim të prodhimeve organike janë të ulëta.



Më pak se 4% nga fondi i bagëtisë është i qertifikuar si organik

- Mungon nxitje për furnizime publike të ushqimit organik, në pajtim me rregullat për furnizime publike ekologjike.

Mbështetja e prodhimit organik

- Në drejtim të uljes së shpenzimeve për qerifikim, nga viti 2021 do të lejohet qertifikim grupor për bujqit e vegjël në pajtim me rregullativën e re e BE-së për prodhim organik.
- Sipas Rregullativës nr. 1305/2013, BE-ja u jep mbështetje fermerëve për transformim në ose mirëmbajtje të prodhimit organik. Mbështetja ofrohet për periudhë prej 5 deri në 7 vjet, me që realizohen pagesa vjetore për çdo hektar për kompensim të të gjitha pjesëve të shpenzimeve plotësuese ose të hyrave të humbura.
- Disa rajone në Itali dhe në Spanjë japin subvencione plotësuese për bujqë të rinjë organik, krahas subvencionimit të përgjithshëm për fillimin e veprimtarisë bujqësore edhe subvencione për bujqë të ri organik. Rajonet e Flandrisë në Belgjikë dhe Madeira në Portugali ju kapin grante më të larta bujqëve organik se sa fermerëve konvencional për investime në fermat dhe për modernizim të pajisjes. Kiproja, Letonia, Estonia dhe Sllovakia japin pikë plotësuesefermerëve organik gjatë ndarjes së granteve për investime në bujqësi.
- Në BE aplikojë masa për diversifikim të të ardhurave të fermave me nxitjen e kulturave të reja jotradicionale, me anë të përpunimit, paketimit, forma të reja të marketingut ose vendosje të agroturizmit.

Kontrolli i prodhimit organik dhe mbrojtja e konsumatorëve

- Në Bashkimin Evropian realizohen sondazhe për njohejn e shenjavenga BE-ja për prodhimet organike dhe informimi i konsumatorëve për prodhimet organike.
- BE-ja ofron mundësi për financim të fushatave të prodhuesve organik, të përpunuesve dhe subjekteve tregtare të cilat kanë për qëllim ta zmadhojnë vetëdijen e konsumatorëve për karakteristikat kryesore të sistemit të prodhimit organik.
- Sipas rregullativës së re e BE-së për prodhim organik nëse paraqiten gjetje të mbështetura se prodhimet organike përmbajnë pesticide, organet nacionale kompetente do të jenë të detyruar që të bëjnë kontrollë, ta determinojnë burimin dhe arsyen për paraqitjen e substancave të tilla.

..... Promovim dhe plasman më i mirë i prodhimeve organike

- Fushatat për edukim të shpensuezve në BE mbështeten me Politikën e Përbashkët Bujqësore, me të cilën mbulohen deri në 70% të shpenzimeve të organizatave të prodhuesve për realizimin e aktiviteteve promovuese, përfshirë edhe reklamimin, degustimin ose pjesëmarrja në panaire dhe ekspozita.
- Në shtetet e zhvilluara të BE-së, supermarketet janë kanali më i rëndësishëm për shitjen e ushqimit organik. Në Holandë, Ministria e bujqësisë ka siguruar ndihmë profesionale nga ekspertë praktik nga sektori agro-ushqimorë të cilët kanë identifikuar mangësi në zinxhirin e prodhimit dhe kanë punuar në nxitjen e prodhimit të prodhimeve organike në sasi dhe cilësi të e kërkojnë supermarketet. Në këtë proces ka qenë e përfshirë edhe asociacioni i zinxhirave të supermarketave të cilat janë betuar për nxitjen e prodhimit organik dhe reklamimin. Qeveria, siguron financime dhe fushata për reklamim nga supermarketet për promovim të prodhimit organik.
- Në Itali aplikohet koncepti i biorajonit. Autoritetet lokale i nxisin restorantet dhe qendrat turistike në biorajonet të orfrojnë prodhime lokale organike, me çka zhvillohet bujqësia organike dhe promovohet rajoni si destinacion për eko-turizëm.
- Prodhimi organik është i përfshirë në kriteret e BE-së për furnizime ekologjike publike për ushqim dhe shërbim. Në Danimarkë, deri në vitin 2020, 60% nga ushqimi në shkollat do të jetë organik. Programi Ambition Bio 2017 në Francë ka përcaktuar qëllim që prodhimet organike të arrijn pjesëmarrje prej 20% nga tregjet të furnizimeve publike.






1. Kreatorë të politikave

Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe menaxhimit të ujit dhe Agjencioni për ndihmë financiare të bujqësisë dhe zhvillimi rural duhet të:

- Informoj prodhuesit organik në mënyrë të thjeshtë, jobirokratike për masat për nxitjen të prodhimit organik dhe si ti shfrytëzojnë.
- Bënë analiza agro-ekonomike me qëllim që ti këshillojnë prodhuesit për zgjedhjen e prodhimit dhe teknik të drejtë për prodhim që do të rezultoj me prdhim profitabil organik i cili do të plasohet në tregun me qmim të pranueshëm. Nevojitet edhe ndihmë gjithpërfshirëse për rritjen e përpunimit të prodhimeve organike me analizë të tregut, ndihmë financiare dhe teknike.
- Ti largojë pengesat për organizimin e prodhuesve organik në shoqata, siç është për shembull efektimi itatimit më të lartë i shoqatave në raport me prodhuesit individual.
- I harmonizojnë dispozitat vendore me rregullativën e re e BE-së për prodhim organik duke e marrë parasyshë përpjekjen e Maqedonisë për anëtarësim në BE.
- Të miratojnë plan të veprimit për nxitjen e përfaqësimit të prodhimeve organike me furnizimet publike, në përputhje me rregullat për furnizime publike të BE-së të cilat janë të përcaktuara edhe në ligjin tonë për furnizime publike. Fillimishtë nxitja e tillë të kryhet me anë të furnizimeve për çerdhet, shkollat dhe spitalet.
- Të vendosin infrastrukturë për tregun publik për blerjen e prodhime organike që do të mundësoj qasje më të lehtë deri tek shitësitë të suhqimit në sasi të vogla.



2. Subjekte kompetente për kontrollë dhe mbikqyrje

Agjencioni i ushqimit dhe veterines, Inspektorati shtetëror për bujqësi dhe trupat për qertifikim duhet të:

- Edukojnë dhe këshillojnë prodhuesit të ushqimit organik për rëndësinë nga aplikimi shenjën e pandryshuar për ushqim organik në prodhimet e tyre, me qëllim që të ndërtohet popullariteti i saj tek konsumatorët.
- E forcojnë sistemin për kontrollë që konsumatorëve të ju sigurohet mbrojtje nga mashtrimi me regjistrimin (shenja), informim ose reklamim joadekuate, me qëllim të rritjes së sigurisë se kur konsumatori paguan për ushqim organik, me të vërtet edhe atë do ta marrë.
- E informoj opinionin për rezultatet nga monitorimi i pesticideve në prodhimin bujqësorë konvencional, si edhe për përfitimet për mbrojtjen e shëndetit të mjedist nga prodhimi organik.
- Regjistër publik i prodhuesve të autorizuar që do të siguroj siguri më të madhe dhe mundësi për kontrollë nga tregtarët për stë se cilat prodhues janë të qertifikuar dhe për cilat prodhime.



3. Prodhuesit organik

Prodhuesit duhet të:

- Të organizohen në shoqata me qëllim që të kenë plasman të përbashkët, bashkimin e sasisë si dhe përcjellje më të lehtë të risive dhe trendeve në prodhimin organik.
- Të ndërtohet strategji të përbashkët për marketing e drejtuar në drejtim të qendrave tregtare, objekteve për shërbim dhe prezencë më të madhe dhe promovim të prodhimeve në internet, në rrjetat sociale dhe në media të tjera.
- Të bëjnë diversifikim më të madhe të prodhimeve dhe shërbimeve të fermave organike, me qëllim që ulët rrezikun nga mospasja të një prodhimi organik, por edhe rritjen të të ardhurave.
- Në mënyrë adekuate të paketojnë prodhimet organike, dhe të rritet niveli i përpunimit të tyre.



4. Organizatat civile që promovojnë ushqim organik

Organizatat civile duhet të:

- Sigurojnë burim plotësues për financim për nxitjen e prodhimit dhe konsumimit të prodhimit organik.
- Fushata organike për rritjen e vetëdijes të konsumatorëve për ushqim organik dhe përfitimet nga mënyra organike e prodhimit.
- Të organizohen aktivitete të rregullta të komunikimit për përfitimet nga "ushqimi i shëndetshëm" i drejtuar në grupe të ndryshme të përzgjedhura.



5. Vende për shitje

Tregjet e gjelbra, marketet, restorante, objektet turistike dhe komanitë për katering duhet të:

- Të sigurojnë qasje më të lehtë të prodhimeve organike në ofertën.
- Kryejnë promovim më të mirë të prodhimeve organike, sidomos të perimeve dhe pemëve, me qëllim të rritjes së shitjes.
- Të krijojnë "hapësira organike" në marketet dhe në tregjet e gjelbra, e sidomos të prodhimeve të freskëta.





<http://organskisvet.mk>



Ky publikacion është i përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian, IRCA dhe partnerë të konsorciumit rajonal, të cilat e realizojnë projektin “Bujqësi të qëndrueshme për Ballkan të qëndrueshëm - forcimi i kapaciteteve të organizatave civile për përfaqësim publik të dhe zhvillimin e politikave të Ballkanit Perëndimor”. Përmbajtja e publikacionit është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në as një rastë nuk mund të llogaritet se i reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian, të ORCA ose të partnerëve të konsorciumit.